



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:273650

Datë: 30.09.2024

Numri i dokumentit: 06229663

C.nr.2743/23

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Gazmend Ajvazi, me bashkëpunëtorin profesional Bionda Rexhepi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses E.I. nga Gjilani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson L.B., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit, vlera e kontestit 628.00 euro, jashtë seancës, me datë 30.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses E.I. nga Gjilani, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit që në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore 04.02.2021 – 01.09.2021, për 96 ditë pune, duke llogaritur nga 2 euro në ditë, t'ia paguaj shumën prej 192.00 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 07.12.2023 si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. HEDHET e palejuar padia e paditëses sa i përket periudhës 01.09.2021 – 21.11.2022, për shkak të ekzistimit të gjyqvarësisë (litispendencës).

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, më datë 07.12.2023 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, në vlerë të kontestit prej 628.00 euro.

Në padi ka theksuar se e njëjta është e punësuar te e paditura në cilësinë e mësimdhënëses, sipas kontratës së punës për kohë të pacaktuar, mirëpo nuk është kompensuar për shpenzimet e ushqimit për periudhën kohore 04.02.2021 – 21.11.2022, përkundër se ky ka qenë detyrim i të paditurës sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Për gjithsej 314 ditë të pranisë në punë, ka kërkuar të kompensohet në shumën prej 628.00 euro. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe të detyrojë të paditurën në kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në shumën prej 628.00 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar pa i specifikuar.

E paditura me shkresën e datës 10.07.2024 ka parashtruar përgjigje në padi lidhur me të gjitha çështjet kontestuese sa i përket kërkesave: shpërbim jubilar, ushqim, udhëtim, kualifikim dhe inflacion, të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2017 dhe 2021 si dhe Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/33 të datës 29.08.2008. Meqë objekt kontesti i kësaj çështje juridike është kompensimi i diferencës për kualifikim dhe inflacion, gjykata vlerëson se kjo shkresë shërben si përgjigje në padi në lëndën konkrete. Kundërshtimet e të paditurës theksojnë se sa i përket kompensimit të shpenzimeve për udhëtim, të njëjtat nuk duhet të njihen nëse nuk argumentohen me prova përkatëse (certifikatë e vendbanimit, pagesë mujore në kompani transportuese, çmimi i biletës...). Sa i përket diferencës në pagë për shkak të kualifikimit, vendimi i qeverisë në fjalë është zbatuar sipas detyrës zyrtare posa ka hyrë në fuqi (me rastin e rritjes së pagave), andaj vendimi i njëjtë nuk mund të zbatohet dy herë. Sa i përket inflacionit, kjo e drejtë nuk i takon të punësuarve në sektorin e arsimit, pasi nuk mund të godet vetëm një sektor të punësimit, por të gjithë sektorët e aparatit shtetëror. Për të gjitha kërkesat, gjykatës i ka propozuar të vlerësojë parashkrimin e tyre, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës dhe kërkesave periodike nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë ka konstatuar se janë plotësuar kushtet për hedhjen e padisë, bazuar në nenin 391 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se për çështjen e ngritur me padi ekziston gjyqvarësia (litispendencia)”; dhe pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të LPK-së, në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësja është në marrëdhënie punë tek e paditura dhe për periudhën kohore 04.02.2021 – 21.11.2022 ka gjithsej 314 ditë pune (vërtetimi nr.prot.153/2023 i dt.10.11.2023 i lëshuar nga SHFMU “Agim Ramadani” në Zhegër).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata vlerësoi se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritore, pasi themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I dhe jo themelësia e refuzuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në Kontratat Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021.

Në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, në nenin 3, paragrafi 2 është përcaktuar se “I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur

marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratës Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”; dhe nenin 35, paragrafi 7 se: “Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është 2€ (dy euro) për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit të kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”.

Dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit për vitin 2017 aplikohen për periudhën 18.04.2017 – 21.01.2021 dhe për vitin 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 – 21.11.2022, zbatimi i të cilave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.40/2023 të datës 27.02.2023 dhe nr.214/2023 të datës 05.10.2023.

Nga këto, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë paditëses, pasi ka gjetur se të njëjtës i takon kompensimi i shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë për periudhën kohore 04.02.2021 – 01.09.2021 (gjithsej 96 ditë të pranisë në punë të kalkuluara për këtë periudhë nga vërtetimi shkollor), ndërsa lartësinë e vërtetoi duke ia llogaritur nga 2 euro në ditë, si në nenin 35.7 të KKAK-së.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për prezumimet ligjore të padisë ka gjetur se kërkesa e paditëses për kompensimin e ushqimit për një pjesë të periudhës është e njëjtë me kërkesën e parashtruar paraprakisht në këtë gjykatë, përkatësisht me padinë e cila evidentohet me numrin e lëndës C.nr.2519/23, padi kjo e cila është ushtruar më datë 24.11.2023, për kompensimin e ushqimit dhe përbën periudhën 01.09.2021 – 21.11.2022.

Sipas padisë C.nr.2519/23 të datës 24.11.2023, paditësja ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për periudhën 01.09.2021 – 21.11.2022, periudhë kjo e cila përfshihet pjesërisht në kërkesën e paditëses sipas kësaj padie, meqë me këtë kërkesëpadi, paditësja kërkon kompensimin për periudhën 04.02.2021 – 21.11.2022. Madje, sa i përket lëndës C.nr.2519/23, më datë 12.03.2024 është marrë aktgjykim për kërkesat e paditëses, i cili vendim ende nuk është i formës së prerë.

Gjykata pasi analizojë lëndët e theksuara si më lartë, gjeti se për periudhën 01.09.2021 – 21.11.2022 bëhet fjalë për çështjen e njëjtë, mes palëve të njëjta ndërgjyqëse, për objektin e njëjtë të kontestit, mirëpo, meqenëse lënda C.nr.2519/23 është proceduar më herët dhe për të njëjtën madje është marrë aktgjykim, atëherë gjykata vendosi ta hedhë poshtë padinë në këtë çështje për shkak të gjyqvarësisë (litispëndencës) sa i përket kësaj periudhe, si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Meqenëse në lëndën C.nr.2519/2023, paditësja për periudhën kohore 01.09.2021 – 21.11.2022 ka provuar se ka pasur gjithsej 218 ditë pune të paditura në SHFMU “Agim Ramadani” në Zhegër, gjykata nga 314 ditë të pranisë në punë për periudhën 04.02.2021 – 21.11.2022, largoi 218 ditët, ashtu që për periudhën 04.02.2021 – 01.09.2021 mbetën vetëm 96 ditë të pranisë në punë për t’u kompensuar për paditësen, prandaj edhe ia njohi kompensimin vetëm për këto ditë.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, pasi paditësja nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës në mënyrë të specifikuar.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 dhe 391.c) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.2743/23, më datë 30.09.2024

Gjyqtari,
Gazmend Ajvazi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit, përmes këtij Gjykate.